-S.T.I.M.P
28.02.2022

BASHKIA MA...
Zyra e Protokollit
Nr. 1161 Prot.
Date 28.02.2022

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**
**KORCE**

---

Korçë, me 22.02.2022

**SHPALLJE VENDIMI**

Drejtuar : Bashkise Maliq

Per: shtetasen : Enkeleda Jaupi me adrese Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 789 dt. 24.09.2021 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " larguar ... " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

**KANCELARE**
**Lubiana KINOLLI**

U afishua sot ne date ----------------------
Per Bashkine Maliq

Nenpunesi ___________________________
(emer, mbiemer, firme)

Nr. 26 Prot
Dt. 03.03.2022

K.Civil, eshte disponuar me vendimin nr.3260 dt.17.05.2021 per "*Shpalljen e moskompetences per ceshtjen familjare me nr.10251 akti qe i perket paditeses Enkeleda Jaupi dhe dergimin e akteve Gjykates te Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Korce...*".

Me depozitimin e ceshtjes ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Korce, ne dt.28.07.2021 ajo i eshte nenshtruar shortit elektronik duke u caktuar ky trup gjykues per shqyrtimin e saj,. Ne vijim Gjykata ka marre te gjitha masat per planifikimin e seances pergatitore (pajtimore) ne referim te nenit 134 te K.Familjes duke urdheruar njoftimin e paleve.

Por ne seancen e dt.24.09.2021 ora 10.30`, paditesja Enkeleda Jaupi nuk eshte paraqitur ndonese kishte marre djeni rregullisht lidhur me zhvillimin e saj nepermjet letethirrjes te dt.02.09.2021 drejtuar asaj ne adresen e kontaktit. Sipas shenimeve te pasqyruara ne leterthirrje, te konfirmuara keto nga punonjesi i sherbimit postar, ka marre djeni avokatja e zgjedhur nga paditesja e cila ka marre persiper njoftimin e saj. Ndersa per te paditurin leterthirrja drejtuar te paditurit ne adresen zyrtare te tij eshte kthyer nga sherbimi postar duke u plotesuar ne formulari perkates, rubrika "refuzuar". Nga ana e kesaj Gjykate eshte pritur pala paditese ne nje afat te arsyeshem kohor ne sallen e planifikuar per tu zhvilluar séanca pergatitore, nderkohe qe gjate kesaj kohe eshte kryer thirrja e saj vazhdimisht nga ana e sekretarise gjyqesore. Nderkohe qe ne kete séance nuk eshte paraqitur edhe i padituri.

Ne te tilla rrethana, referuar nenit 179 paragrafi i pare i K.Pr.Civile sipas te cilit : "*Nese paditesi ose asnje nga palet pa ndonje shkak te arsyeshem, nuk paraqiten ne séance pergatitore... dhe rezulton se kane djeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit te ceshtjes*"; nenit 299 po te K.Pr.Civile sipas te cilit : " *Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ...ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht ne ligj.*"; dhe se fundi percaktimin e nenit 135 te K.Familjes, ne te cilin ligjvenesi ka parashikuar shprehimisht pushimin e gjykimit te ceshtjes ne rast mosparaqitje personalisht te paditesit/es ne séance pergatitore dhe te zbatuara keto per rastin ne gjykim, cmon se jane kushtet ligjore te parashikuara prej tyre per pushimin e gjykimit te kesaj ceshtje civile.

Persa i perket shpenzimeve gjyqesore te evidentuara deri ne kete faze te gjykimit ato rezultojne pjesrisht te parapaguara nga pala paditese ku perfshihet vetem tarifa mbi aktet. Referuar nenit 106 e vijues te K.Pr.Civile ne kushtet e pushimit te ceshtjes per shkak te mosparaqitjes te pales paditese, nga gjykata cmohet qe ato ti lihen ne ngarkim asaj, pra sic jane kryer.
Sa me siper provohet nepermjet dokumentave shkresore te ndodhura ne dosjen gjyqesore.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te nenit 127, 179/1, 299/ *ç* te K.Pr.Civile dhe 135 te K.Familjes

**V E N D O S I**

Pushimin e gjykimit te ceshtjes civile me nr.regj.them 21001-01251-41-2021 (1178) date regj.28.07.2021, me pale ndergjyqese : paditese Enkeleda Jaupi, i paditur Dorian Jaupi, me objekt : "*1). Zgjidhja e marteses dhe lenia per kujdestari e dy femijeve te mitur dhe caktimi i pensionit ushqimor. Ndryshimi i mbiemrit ne mbiemrin e vajzerise "Berisha"*

Shpenzimet gjyqësore te parapaguara nga pala paditese lihen ne ngarkim te saj.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit te vendimit te arsyetuar në Gjykatën e Apelit Korçë.

U shpall ne Korçe sot ne dt.24.09.2021 ora 10.35`.

**SEKRETARE**
**Eriselda ELMAZAJ**

**GJYQTARE**
**Eglantina MIKANI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORCE

NR.REGJ.THEM.21001-01251-41-2021 (1178)
DT.REGJ.28.07.2021

NR.VENDIMI 41-2021-2957(789)
DT.VENDIMI 24.09.2021

# V E N D I M

" Ne emer te Republikes"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce e perbere prej :

**Gjyqtare : Eglantina Mikani**

Asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Eriselda Elmazaj, ne dt.24.09.2021 mori ne shqyrtim ne seance pergatitore me dyer te hapura ceshtjen civile me nr.regj.them. 21001-01251-41-2021 (1178) date regjistrimi 28.07.2021 qe i perket:

**Paditese :** Enkeleda Jaupi, e bija e Lulezim dhe Hasime, e dtl.1991, lindur ne Kruje, dhe banuese ne Maliq, Korce, me adrese kontakti : Rr."Barrikadave", nr.2, ne mungese.

**I paditur :** Dorian Jaupi, i biri i Flamur dhe Myrvete, e dtl.1980, lindur dhe banues ne Maliq, Korce, (*me vendqendrim ne adresen : Itali, Rr."San Giacomo, della Vittoria, nr.60, Aleksandria*), ne mungese.

**Objekti :** Zgjidhja e marteses dhe lenia per kujdestari e dy femijeve te mitur dhe caktimi pensionit ushqimor. Ndryshimi i mbiemrit ne mbiemrin e vajzerise "Berisha".

**Baza ligjore :** neni 153, 154, 154/a, 156 dhe 358-365 te K.Pr.Civile dhe 129-139, 142, 147, 156 te K.Familjes.

Gjykata, pasi konstatoi mungesen ne gjykim te paleve ndergjyqese dhe pasi shqyrtoi aktet e bisedoi ne teresi ceshtjen

## V E R E N

Me kerkese padi te depozituar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane ne dt.05.03.2021 paditesja Enkeleda Jaupi duke thirrur si te paditur bashkeshortin e saj Dorian Jaupi ka kerkuar : " *Zgjidhja e marteses dhe lenia per kujdestari e dy femijeve te mitur dhe caktimi pensionit ushqimor. Ndryshimi i mbiemrit ne mbiemrin e vajzerise "Berisha*" kerkime te cilat i ka bazuar ne nenin 153, 154, 154/a, 156 dhe 358-365 te K.Pr.Civile dhe 129-139, 142, 147, 156 te K.Familjes.

Por ne kushtet kur nga kjo Gjykate eshte konstatuar sipas certifikatave te leshuara nga Zyra e Gjendjes Civile, Njesia Administrative Maliq, Bashkia Maliq e te paraqitura se bashku me kerkesepadine per shqyrtim, se palet ndergjyqese kane vendbanimin e tyre ne Njesine Administrative Maliq, Bashkia Maliq, ne referim te nenit 36/1, 41 dhe 51 te